



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 1334 Prot.

Tiranë, më 28.04.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1933/5, DATË 28.03.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. GËZIM VASI”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Gëzim Vasi nr. 677 prot., datë 25.03.2022, nr. 2884 prot., datë 10.10.2022, nr. 990 prot., datë 29.03.2023 dhe nr. 990/2 prot., datë 27.06.2023, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve K.L.I. me detyrë prokuror dhe në të njëjtën kohë drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, A.H., me detyrë prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, J.Ç., A.M. me detyrë prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithëm Gjyrokastër dhe ndaj Sh.L. me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë Sarandë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 1933/5 prot., datë 28.03.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Gëzim Vasi”, bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Fier, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja “15 Tetori”, Rruga “Kastriot Muço”, përballë Gotech, Fier;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

